

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZONI PENAL, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarve: M. A. dhe L.G., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1.pika 1. lidhur me nenin 23 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.1773-12/2009 dt.03.06.2009, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me datë 28.01.2015, në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore nga Prishtina-Remzush Latifi, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre av. B.E. dhe av. H.G. sipas autorizimeve, me datë 29.01.2015, mori dhe shpalli aktgjykimin, përpilimi i aktgjykimit u bë konform nenit 370 të KPPRK-së, me datë 26.02.2015,

A K T G J Y K I M

I akuzuari M.A., me nofkën M., i biri i I. dhe Sh. e gjinisë B., i lindur më *data e lindjes...*, P., tani me vendbanim në fshatin P. Komuna e P., i martuar baba i një (1) fëmiu, ka të kryer shkollën mesme, punon në KEDS, i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar, kundër tij nuk ka të dhëna se zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovë, ka qëndruar në arrest shtëpiak në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh gjegjësisht prej datës 14.05.2009.

I akuzuari L. G., me nofkën D., i biri i H. dhe N. e gjinisë Rr., i lindur më *data e lindjes...*, në P., tani me vendbanim në F. K. rruga “...” pn, me nr. personal, *numër personal...*, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar, kundër tij zhvillohet procedurë tjetër penale në Gjykatën Themelore në Prishtinë për vepër penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 të KPRK-së, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovë, ka qëndruar në arrest shtëpiak në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh gjegjësisht prej datës 27.05.2009.

J A N Ë F A J T O R Ë

Sepse:

Me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme, vetit t'i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, pas marrëveshjes paraprake për të vjedhur në bashkëveprim, me dt.29.04.2009, rreth orës 01:00, në Podujevë, në rrugën “Zahir Pajaziti”, posa janë afruar afër lokalit DPZ “B.” të dëmtuarit H.J., me përdorimin e forcës, me dana, kaçavida dhe me anën e një pajseri kanë këputur drynin e derës, me forcë kanë hapur derën e lokalit, kanë hyrë brenda dhe nga aty kanë marr, një kasafortë (arkë) të metaltë në të cilën gjendeshin, dy makina për shumëzimin e çelësave, njëra e tipit “Borkey” dhe njëra e tipit “Kanash”, 2.000 (dymijë) copë çelësa të llojeve të ndryshme, një aparat digjital, 80 telefona të llojeve të ndryshme, 10 copë të tipit “LG”, 10 copë “Sony Erikson”, 20 copë “Samsung”, 40 copë “Nokia”, tre copë MP3 MP4, tri pako (kutia) me vegla të ndryshme – 15 copë qipa të çelësave me kod dhe një sasi të pjesëve rezervë të makinave për shumëzimin e çelësave, këto sende i kanë vendosur dhe bartur me një karrocë dore, me ç'rast të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material,-

Me këtë në bashkëveprim kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së,

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3, 6, 11, 15, 34, 36, 38, 64, 73 dhe në bazë të nenit 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, si dhe në bazë të neneve 365,450,453,463 të KPPRK-së, i

G J Y K O N

I.Të akuzuarin **M. (I.) A.**, me dënim me burg, ashtu që i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej **8 (tetë) muajve**, të cilin do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak në kohëzgjatje prej **30 (tridhjetë) ditësh, gjegjësisht prej datës 14.05.2009.**

II.Të akuzuarin **L. (H.) G.**, me dënim me burg, ashtu që i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve**, të cilin do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak në kohëzgjatje prej **30 (tridhjetë) ditësh, gjegjësisht prej datës 27.05.2009.**

III.I dëmtuari H. (L.) J., nga fshati S., KK. P., për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

IV. Detyrohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë shumën aq sa bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërsa në emër të shpenzimeve paushalle të paguajnë shumën prej **150€** (njëqind e pesëdhjetë / euro), **secili veç e veç**, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

A r s y e t i m

PPK-në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.nr.1773-12/2009 dt.03.06.2009, kundër të akuzuarve: E.D., D. J., M. A. dhe L.G., për shkak se në bashkëveprim kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1.pika 1.lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale Gjykata mbajti shqyrtimet gjyqësore me datë 27.10.2014, 22.12.2014, 09.01.2015 dhe 28.01.2015, në praninë e prokurorit të Shtetit, të dëmtuarit, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të datës 27.10.2014 dhe 09.01.2015 me aktvendime të veçanta e ka veçuar procedurën për të akuzuarin D. J. dhe E. D. pasi që nga Informatat e Stacionit Policor në Podujevë të datës 22.10.2014 dhe 09.01.2015 thuhet se janë larguar nga Kosova.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2015 i akuzuari L. G. pas konsultimit me mbrojtësin e tij deklaroi se e pranon fajësinë në tërësi për të gjitha pikat e aktakuzës.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit L. G., si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, mbrojtësit të tij dhe të dëmtuarit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor, andaj gjykata konform nenit 326 par. 5 të KPPRK-së, shpalljen e aktgjykimit për të akuzuarin L.G. e bëri pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

I akuzuari M.A. në shqyrtimin gjyqësor u deklarua i pafajshëm për veprën penale për të cilën akuzohet.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi: Nga provat e administruara në shqyrtimet e mbajtura në këtë gjykatë konsideroj se të pandehurit M. A. dhe L.G. në bashkëveprim kanë kryer veprën penale që ju vihet në barrë me datë 29.04.2009 duke përdorur forcën dhe me mjetet për thyerjen e lokalit siç janë: danat, kaçavida dhe pajseri, e kanë këputur drynin e derës duke u futur në lokal dhe duke i vjedhur sendet të cilat janë përmendur gjatë shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri L.G. e pranoi fajësinë dhe u pendua thellë gjithashtu edhe i pandehuri tjetër M.A. në një formë e pranon fajësinë mirëpo ndërkohë që t'i ikë përgjegjësisë penale e mohon kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë. I propozoi gjykatës që të pandehurit t'i shpallë fajtorë dhe të dënohen me dënim të merituar sipas ligjit.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështetë fjalën e prokurorit të shtetit dhe parashtrroi kërkesë pasurore-juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit M. A. av.B. E. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Se prokuroria nuk ka ofruar prova me të cilat do të vërtetohej se klienti im ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, ngase me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetoj se në kohën e kryerjes së

veprës penale ka qenë në lokalitetin D.P.Z. "B." dhe as me rezultatin e ekzaminimit të gjurmëve latente të gishtërinjve në sistemin e afisit në Prishtinë, e gjithashtu nuk ka ofruar prova me të cilat do të vërtetohet dyshimi i bazuar mirë lidhur me mënyrën e kryerjes së veprës penale. I propozoi gjykatës që të marrë aktgjykimin lirues në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.3 të kodit të procedurës penale.

I akuzuari M. A. në shqyrtimin gjyqësor deklaroi se e shfrytëzon të drejtën e mbrojtjes në heshtje, ndërsa në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit L. G., av.H. G. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: I mbrojturi im pas konsultimit e ka pranuar kryerjen e veprës penale në tërësi sipas aktakuzës, është përdur duke garantuar se asnjëherë nuk do të merret me veprime jo ligjore, duke i kërkuar falje të dëmtuarit, i mbrojturi im në kohën e kryerjes së veprës penale ishte madhor i ri sepse kishte 18 vjet e 6 muaj e disa ditë, ka luajtur një rol të ruajtjes dhe ka marrë 3 telefona të cilët i ka shitur për afërsisht 50 euro, i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit të aplikoj dispozitat e nenit 75 dhe 76 për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe t'i shqiptoj dënime alternative apo dënim me kusht, ashtu që edhe me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

I akuzuari L. G. në fjalën përfundimtare deklaroi: Se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe shtoi se është përdur, i kërkoj falje të dëmtuarit, ndjen keqardhje, kërkoj nga gjykata që t'i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor vërtetoi këtë gjendje faktike: Se i akuzuari M.A. me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme, vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, pas marrëveshjes paraprake për të vjedhur në bashkëveprim, me dt.29.04.2009, rreth orës 01:00, në Podujevë, në rrugën "Zahir Pajaziti", posa janë afëruar afër lokalitetit DPZ "B." të dëmtuarit H. J., me përdorimin e forcës, me dana, kaçavida dhe me anën e një pajseri kanë këputur drynin e derës, me forcë kanë hapur derën e lokalitetit, kanë hyrë brenda dhe nga aty kanë marrë sendet e cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të cilat i kanë vendosur dhe bartur me një karrocë dore.

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi nga deklaratat e të dëmtuarit-dëshmitarit H. J., dëshmitarit A. Xh., zyrtarëve policor Sh. P. dhe A. J., lista e provave materialeve të datës 13.05.2009 dhe foto-dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, si dhe deklarata e të akuzuarit M. A. dhënë në Stacionin Policor në Podujevë me datë 14.05.2009.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje penale këto prova gjykata konform nenit 8 dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura në shqyrtim gjyqësor që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegjeje vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, si dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Nga deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit H. J. vërtetohet gjendja faktike, i cili veç tjerash deklaroi: Se me dt.29.04.2009 në mëngjes jam telefonuar nga myshterit se a je duke punuar për shkak se e kanë parë lokalin të hapur, kur kam shkuar në lokal kam parë derën e hapur dhe gjësendet të cilat kanë qenë për toke, kur kam hyrë brenda e kam parë se mungojnë sendet të cilat janë cekur në aktakuzë, dryni kishte qenë i këputur dhe dera kishte qenë e hapur dhe menjëherë i kam lajmëruar policinë, kam kontaktuar me dyqanet me të cilat prodhojnë çelësa në Podujevë dhe në Prishtinë që nëse dikush eventualisht vjen për të shitur çelësa më lajmëroni, dhe më ka lajmëruar A.Xh. që të shkoj t'i shikoj disa çelësa, më ka thënë se personi i cili m'ka shitur gjendet në lokalin tim, kur kam shkuar në dyqan të A. Xh. e kam parë të akuzuarin E. D. duke dalë nga ai lokal, unë kam qenë duke hyrë dhe ai ka dalë menjëherë i cili kishte shkuar për t'ia sjellë edhe makinat, këtë të akuzuar nuk e kam njohur më herët ndërsa të tjerët po, D., M. dhe L., duke shtuar se M. e kam pasur edhe myshteri që përafërsisht për çdo 2-3 ditë ka qenë në lokalin tim i cili një natë ose dy para se të ndodhë vjedhja në lokalin tim M. ka qenë dhe ka kërkuar për ta blerë një telefon, e kam hapur kasafortën dhe i njëjti i shikuar telefonat. M. e ka pasur vendbanimin-banesën përball lokalit tim dhe vetëm ky i ka parë se ku i lë telefonat, ngase kasafortën nuk e hapi çdo herë.

Nga deklarata e dëshmitarit A.Xh. vërtetohet gjendja faktike, i cili veç tjerash deklaroi se në atë kohë isha pronar i lokalit "C." në rrugën "Gilbardi" në Prishtinë, fillimisht deklaroi se mbetem në tërësi pranë deklaratës së dhënë në polici pasi që ka kaluar një kohë e gjatë dhe mund të kem harruar gjëra konkrete, me datë të saktë nuk e di por është e vërtet se një person mu ka prezantuar se është i Kamenicës kinse i kishte vdekur vëllau dhe i kishin mbetur çelësat dhe makinat, kurse të hollat i shërbejnë për ta rregulluar varrin. I kam blerë dhe e kam thirrur H. që të vij t'i verifikoj se a janë çelësat e tij, i njëjti person prapë më ka telefonuar dhe më ka thënë se i ka dy makina për çelësa dhe të njëjtit i thash që të m'ia sjell dhe e kam thirrur prapë H. për të ardhur dhe personi po sa ka hyrë në lokal e ka parë H. dhe menjëherë ka ikur me vrap ka dalë nga lokali. Meqë ka kaluar kohë e gjatë rreth 5 vite, nuk mundem ta identifikoj, ndërsa në polici ditën e dytë apo tretë kam arrit ta identifikoj.

Nga dëshmia e zyrtarit policor Sh. P. i dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit veç tjerash deklaroi: Ne si polici të gjitha veprimet i zhvillojmë konform kodit të procedurës penale, në bazë të procedurave dhe parimeve të brendshme të policisë si dhe në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit. Në bazë të veprimeve operative-hetimore, gjurmuese të policisë lidhur me veprën penale vjedhje e rënd kemi arritur t'i identifikojmë disa persona të dyshuar, në rastin konkret personin me nofkën "M.", e më pastaj kemi siguruar informata se ai quhet M. A. të cilin e kemi ftuar në Stacionin Policor në Podujevë, kemi filluar me intervistim duke respektuar parimin e ligjshmërisë, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e mbrojtjes së lirisë dhe të drejtave të njeriut, të dyshuarit i kemi lexuar të gjitha të drejtat e cekura në procesverbal në mesin e të cilave edhe e drejta e mbrojtësit të cilën gjë i dyshuari e ka refuzuar me nënshkrimin e ti në procesverbal, e të cilat të drejta ju kanë lexuar para fillimit të intervistimit e po ashtu deklaratën të cilën e ka dhënë i është lexuar edhe në fund të intervistimit të cilën e ka kuptuar dhe e ka nënshkruar, dhe nuk është e vërtetë se ne e kemi sulmuar.

Nga dëshmia e zyrtarit policor A. J. i dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit veç tjerash deklaroi: Ne si zyrtar policor kemi intervistuar të dyshuarin konform dispozitave të kodit të procedurës penale, të gjitha të drejtat janë të cekura në procesverbal e të cilat janë lexuar për veprën penale për të cilën dyshohet të drejtën për të pasur mbrojtës-avokat, po ashtu e kemi

njoftuar se deklarimi i tij mund të përdoret si provë në gjykatë, i njëjti ka pranuar të jep deklaratë pa mbrojtës e të cilën edhe e ka nënshkruar, të gjitha të drejtat ju kanë lexuar para fillimit të intervistimit dhe në fund të intervistës dhe deklaratën e kemi marr pa kurrfarë presioni fizik e psikik.

Nga listat e provave materiale të datës 13.05.2009 vërtetohet se disa sende të vjedhura i janë kthyer të dëmtuarit H. J..

Nga foto-dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës shihet lokali i thyer, mënyra e kryerjes së veprës penale dhe sendet e demoluara të dëmtuarit.

Nga deklarata e të akuzuarit M. A. e dhënë në Stacionin Policor në Podujevë me datë 14.05.2009 vërtetohet se i akuzuari në tërësi e kishte pranuar kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i cili kishte theksuar se me datë 29.04.2009 rreth orës 1:00 në bashkëpunim me shokët E. D., D. J. dhe L. G. kemi kryer vjedhjen në lokalin që është saktësisht përball PTK-së, nën banesa në rrugën “Zahir Pajaziti” në Podujevë që gjendet përball banesës time, unë në atë lokal kam pasur njohuri se ka telefona të ndryshëm të shtrenjtë, sepse aty kam hyrë disa herë kam blerë telefona dhe e njoh pronarin. Atë natë kur kam dalë nga banesa jam takuar me shokët e mi të cilët ishin të pajisur me dana, kaçavida, pajser dhe një karrocë dore, derën e kemi hapur me dhunë (kaçavidë dhe dana) kemi depërtuar brenda dhe nga aty kemi vjedhur kasafortën, çelësa të ndryshëm, makina të çelësave, telefona celular dhe gjësende tjera të cilat i kemi vendosur në karrocë dhe me kujdes kemi kaluar rrugën duke vazhduar përmes urës së lumit (Llap) deri në rrugën e Xhamisë, ata kanë vazhduar rrugën e unë jam kthyer në banesë. Të nesërmen jemi takuar, m’i kanë dhënë tre telefona, një “Samsung” dhe dy “Nokia” dhe unë kam shkuar me skuter në Prishtinë me tre telefonat dhe i kam shitur për 20 euro një tregtari të pa njohur dhe ka shtuar se jam penduar për këtë vjedhje duke kërkuar falje.

Pas administrimit dhe vlerësimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, gjykata sipas bindjes së lirë vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ju dhënë besimin e plotë deklaratës së të dëmtuarit-dëshmitarit H.J., dëshmitarit A.Xh., listave së provave materialeve të datës 13.05.2009 dhe foto-dokumentacionit i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe deklaratës së të akuzuarit M. A. dhënë në Stacionin Policor në Podujevë me datën 14.05.2009, të cilat ndërlidhen njëra me tjetrën se i akuzuari M. A. në bashkëkryerje ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në mënyrë të hollësishme analizoi mbrojtjen e të akuzuarit M. A. të ushtruar nga mbrojtësi i tij av. B.E. duke e hedhur poshtë si të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, pretendimet e tij për shpalljen e provës së pa pranueshme të deklaratës së tani të akuzuarit M. A. me arsyetim se është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore duke mos i ofruar mbrojtjen, gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar nga se këto pretendime janë vërtetuar gjatë shqyrtimit gjyqësor me dëgjimin e zyrtarëve policor Sh. P. dhe A. J. të cilët deklaruan se gjatë intervistimit janë respektuar të gjitha të drejtat procedurale sipas kodit të procedurës penale dhe në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit, duke ju ofruar mbrojtjen sipas detyrës zyrtare, mirëpo i akuzuari kishte refuzuar gjë që vërtetohet me nënshkrimin e tij. Dhe po ashtu pretendimet e të akuzuarit dhe të mbrojtësit të parë të tij av. F.A. sa i përket ndërhyrjes fizike, keqtrajtimit apo shtrëngimit

gjatë intervistimit apo marrjes në pyetje në polici i akuzuari dhe mbrojtësi i tij nuk e dëshmoi me asnjë raport të vetëm mjekësor për lëndimet e pësuar, e që rezultoi se marrja në pyetje e tij nuk është bërë në mënyrë kundërligjshme. Andaj gjykata nuk kishte arsye që mos ta marr për bazë deklarin e tij në polici ku e kishte pranuar në tërësi fajësinë duke deklaruar në hollësi veprimet e ndërmarra për kryerjen e veprës penale. Kjo u vërtetua edhe nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe nuk është fare kontestuese mbrojtja e të akuzuarit M. A. se është e orientuar nga ikja e përgjegjësisë penale duke e mohuar tani kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale me dashje, me paramendim, sepse kanë qenë të vetëdijshëm për veprimet e tyre dhe e kanë dashur kryerjen e veprës penale.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarve, kështu që gjykata gjeti se të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga provat e administruara, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarve M.A. dhe L.G. përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Me rastin vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 64 të KPK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti për të akuzuarin L.G. pranimin e fajësisë, gjatë shqyrtimit gjyqësor duke u penduar dhe shprehur keqardhje, ishte korrekt gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor, në kohën e kryerjes së veprës penale ishte i moshës së re, më parë i pa gjykuar, ndërsa për të akuzuarin M. A. gjykata rrethanë lehtësuese ka gjetur se ishte korrekt gjatë shqyrtimit gjyqësor, më parë i pa gjykuar, në kohën e kryerjes së veprës penale ishte i moshës së re, duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti shkallën e lartë të dashjes, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur e që është prona private, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale është shqetësuese, ku është krijuar një pasiguri e madhe e shoqërisë në Kosovë, se ky lloj i veprave penale është bërë dukuri e shpeshtë në vendin tonë, andaj gjykata të akuzuarit i shpalli fajtorë dhe i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të cilin dënim do ta mbajnë pasi aktgjykim të merr formën e prerë, në të cilin dënim ju llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak, konsideroi se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale si dhe përgjegjësisë penale dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tyre dhe si masë parandaluese me efekt në persona të tjerë për moskryerjen e veprave penale e të parapara sipas dispozitës së nenit 34 të KPK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar është marrë në kuptim të nenit 73 të KPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko-civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u marrë në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1. dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.527/09, dt.26.02.2015**

**Sekretarja Juridike
Mihrie Sheholli**

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashirojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.